




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



RTK 1
Lorik Arifaj
Drejtor
Prishtinë



VENDIM

**Lidhur me rastin nr. 2021/21 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër
RTK 1 (Palë përgjegjëse)**

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) më datën 22 dhjetor 2017 ka miratuar Rregulloren KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, me të cilën janë përcaktuar parimet themelore të komunikimeve komerciale audiovizuale gjatë emetimit të tyre nga ofruesit e shërbimeve mediale, duke përfshirë përmbajtjen, çështjet etike dhe kohëzgjatjen e komunikimeve komerciale audiovizuale.
2. KPM, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës përgjegjëse me Rregulloren KPM-2017/07, ex officio ka iniciuar monitorimin e këtij subjekti me datën 17 janar deri me 2 shkurt 2021. Bazuar në Raportin e monitorimit KPM ka gjetur se Pala përgjegjëse me datat 17, 22, 24, 27, 29, 30 dhe 31 janar 2021 ka transmetuar program audiovizual të sponsorizuar nga subjektet politike Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), duke vepruar në kundërshtim me Rregulloren KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.
3. KPM pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 4 shkurt 2021, i ka dërguar Palës përgjegjëse Shkresë, me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e gjetura dhe e ka udhëzuar që të ofrojë sqarime lidhur me transmetimin e programeve të sponsorizuara nga partia politike.
4. KPM me datën 8 shkurt 2021 ka pranuar përgjigje nga Pala përgjegjëse, në të cilën kanë theksuar se nuk bëhet fjalë për program të sponsorizuar por për vlerësim editorial që këto aktivitete mund të transmetohen në funksion të informimit të audiencës, duke qenë të hapur për të gjitha subjektet politike.

Analiza ligjore

5. Komisioni i KPM-së, gjen se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 14 paragrafi 5 i Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.

6. KPM ka gjetur se Pala përgjegjëse ka transmetuar program audiovizual të subjekteve politike Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) para fillimit të fushatës, veprim ky që bie në kundërshtim me nenin 14 paragrafi 5 i Rregullores KPM-2017/07, i cili përcakton se:

“Partitë politike dhe koalicionet nuk do të jenë sponsorë të programeve audio-vizuale përveç gjatë kohës së promovimit zgjedhor në pajtim me një akt të veçantë.”


7. Prandaj, KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka gjetur se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 14 paragrafi 5 i Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.

Vendim

8. Pala Përgjegjëse sanksionohet me Vërejtje në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 14 paragrafi 5 të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.

E drejta për ankesë

9. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
10. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjrisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Xhevat LATIFI
Kryetar



11.02.2021
Datë